

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIIONIN

Një Sistem Cilësia për Statistikat:
Aktiviteti 1.2.1.2: Vazhdim i përkrahjes së punës rreth Cilësisë në ASK

Komponenti 1

Mision i realizuar nga Lars Thygesen dhe Hilka Vihavainen

14-16 April 2015

IPA 2012

Emri, adresa, e maili i autorit

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4554627664
Mob: +4528403941
Email: lthygesen@gmail.com*

*Hilkka Vihavainen
Statistics Finland
Verkstadsgatan 13
FI-00022 Helsinki
Finland
Tel: +358 50 5002296
Email: hilkkal.vihavainen@gmail.com*

Përmbajtja

Tabela e përmbajtjes	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Lista e shkurtesave.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komete të përgjithshme	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	5
3.1 Përfshirja e përdoruesve	5
3.2 Zhvillimi i trajnimeve për stafin.....	6
3.3 Fuqizimi i rëndësisë së çështjes së konfidencialitetit në ASK	6
3.4 Rekomandimet për punën e Komitetit për Cilësi	6
3.5 Misioni i ardhshëm.....	7
Puna në të ardhmen	8
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	9

Lista e shkurtesave

CoP	Kodi i Praktikës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
QAF	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
TeR	Termat e Referencës
SAQ	Pyetësi i vetëvlerësimit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Nderkombëtar
SIMS	Struktura e vetme e integruar për metadatat (standard i EUROSTAT-it për metadatat)

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është realizuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Është misioni i shtatë kushtuar komponentit 1 të projektit. Qëllimi kryesor i misionit ishte përcjellja e arritjeve të realizuara deri tani dhe ofrimi i rekomandimeve se si të zhvillohet më tej puna rreth cilësisë në ASK.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së, Statistikave të Danimarkës/Finlandës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Konsulentët kanë pasur tre takime me Komitetin për Cilësi. Në takimin e parë u paraqitën e aktivitetet e zhvilluara që nga misioni i fundit (Tetor 2014). Më pas kryesuesi i Komitetit për Cilësi paraqiti detyrat dhe gjendjen aktuale në lidhje me to (teksti në italic):

- Analizimi i rezultateve të anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve, të mbajtur në Tetor 2014: *Fatkeqësisht deri tani nuk janë publikuar rezultatet.*
- Finalizimi i analizës së kompetencave/nevojave për trajnim, përgatitja e një plani mbi trajnimet: *Është përpiluar një matriks për vlerësimin e shkathhtësive ekzistuese dhe të nevojshme për secilin punonjës dhe i njëjti u është shpërndarë shefave/drejtorëve të divizioneve/departamenteve. Deri tani nuk janë paraqitur nevojat specifike për trajnime. Prandaj, u thirr një takim për ditën tjetër me drejtorët/shefat për të specifikuar nevojat për trajnime.*
- Zgjerimi dhe përdorimi i listës kontrolluese në procesin e anketave: *Nuk është përdorur në masë të gjerë. Më shumë anketa duhet të përdorin listen kontrolluese.*
- Mandati i Komitetit për Cilësi: *Është përgatitur por për miratimin final priten komentet nga zyra Ligjore e Kryeministrit.*
- Plotësimi i pyetësorit të vetë-vlerësimit të BE-së lidhur me parimin 4 të Kodit të Praktikës: *Është bërë gjatë dhe ekspertët dhanë komentet e tyre gjatë misionit.*
- Plotësimi i pyetësorit të vetë-vlerësimit të BE-së lidhur me koordinimin- fundi i 2014: *nuk është bërë.*
- Përcjellja e punës rreth metadatave, sigurimi i rezultateve konkrete: *Kjo po zhvillohet mirë me projektin e SIDA-s. Është parashikuar që të gjitha metadatat të jenë të gatshme në vitin 2016.*
- Me një fjalë: Fuqizimi i punës së Komitetit për Cilësi (planifikoni-implementoni-monitoroni-vlerësoni): *Puna ka vazhduar por pa një plan dhe jo në mënyrë të rregullt.*
- Deklarata e Komitetit për Cilësi është miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe do të publikohet në webfaqen e ASK-së.

Gjatë takimit të dytë me Komitetin për Cilësi u diskutua në lidhje me kërkesat për implementimin e Kodit të Praktikës. Konsulentët kaluan nëpër parimet 1-2, 5 dhe 15 bashkë me anëtarët e Komitetit për Cilësi. Ideja ishte të identifikohen fushat e mundshme për përmirësim me qëllim implementimin e Kodit të Praktikës. Nga kjo doli qartë që

- Stafit nuk ka njohuri të mjaftueshme lidhur me Kodin e Praktikës, modelin GSBPM dhe standardet e cilësisë
- Përputhshmëria e ASK-së me Kodin e Praktikës: u diskutuan parimet 1-2, 5 dhe 15
- Parimi 1: Është problem për pavarësinë e ASK-së që Kryeshefi emërohet vetëm për vjet dhe procesi i emërimit/shkarkimit nuk është i rregulluar, ose transparent. Gjatë 10 viteve të fundit ka pasur 10 kryeshefë, që nuk është gjë e mirë për qëndrueshmërinë dhe rregullimin e organizatës.
- Parimi 2: ASK-ja ka qasje në të dhëna administrative. Qasja është e garantuar me ligj. Megjithatë, ndonjëherë ka probleme teknike, por në përgjithësi duket që nuk ka problemet e mëdha në këtë aspekt.
- Parimi 5: ASK-ja nuk ka një Politikë mbi Konfidencialitetin, dhe as një person përgjegjës për çështje të konfidencialitetit.
- Parimi 15: ASK-ja nuk ka një Politikë Diseminimi.

Gjatë takimit të tretë me Komitetin për Cilësi u diskutuan gjetjet e këtij misioni dhe rekomandimet për të ardhmen. Rekomandimet paraqiten në seksionin në vazhdim.

Takimi lidhur me nevojat për trajnime u mbajt me të gjithë shefat/drejtorët në ASK. Ibrahimit prezantoi rezultatet e matriksit. Ato ishin interesante dhe tregonin që ka nivele të ndryshme shkathtësisë dhe mangësisë. Pati disa kritike në lidhje me metodologjinë e përdorur, p.sh. nuk ka pasur instruksione të qarta, shoqëruese të matriksës, tabela vetëm në gjuhën angleze etj. Në përgjithësi shumë pjesëmarrës mendonin që matriksa është një fillim i mirë për specifikimin e nevojave për trajnime. Megjithatë, atyre u duhej më shumë kohë për të specifikuar këto nevoja. U vendos që secili do të

- Analizojë më tej matriksën
- Do të përgatisë një paragraf të shkurët në gjuhën shqipe me 5 prioritetet të
 - nevojave specifike, bashkë me numrin e personave që kanë këto nevoja
- Do të dorëzojë këtë informacion të Ibrahimit deri te premtën, 17 Prill 2015
- Nora do të ndihmojë në sintetizimin e këtyre informative dhe përkthimin e tyre në gjuhën angleze
- Disa nevoja për trajnime do të mund të mbuloheshin në kuadër të projektit aktual të binjakëzimit, disa në kuadër të projekteve të tjera.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

3.1 Përfshirja e përdoruesve

Në takimin me përdoruesit, të mbajtur në Tetor të vitit 2014, u ndërmorr një anketë mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. ASK-ja ka përgatitur një raport të shkurtër me rezultatet e kësaj ankete. Deri tani nuk janë publikuar këto rezultate. rekomandohet që disa nga këto të paraqiten në webfaqen e ASK-së. Do të duhej që këtë vit të mbahej një anketë edhe më e gjerë me përdoruesit. U vendos që forma dhe shtrirja e kësaj ankete do të diskutohen më gjerësisht gjatë misionit 4.9.1 mbi strategjinë dhe politikën e diseminimit, që do të mbahet në Maj. Politika e diseminimit do të duhej të përfshinte edhe një deklaratë mbi atë se si ASK-ja trajton kritikën jorëkorte ose keqpërdorimin e statistikave, të paraqitura në media. .

Zhvillimi dhe hapja e Dataabankës Statistike mbetet akoma prioritet. Do të jetë e gatshme për hapje në një periudhë afatshkurtër. Konsulentët theksuan rëndësinë e shfrytëzimit të rastit të hapjes së Databankës për përfshirjen më të madhe të përdoruesve. Takimi i ardhshëm me

përdoruesit do të mund të bëjnë në të njëjtën kohë me hapjen e Databankës, ose në vjeshtë, ndoshta në Tetor. .

U rekomandua qysh në Tetor të vitit të kaluar që pas hapjes së Databankës të organizohet një takim i nivelit të lartë me Ministrin etj. me qëllimin që të përpiqet të ndikohet në çështjen e resurseve të ASK-së. Ky rekomandim vlen akoma dhe ekspertët mund të kontribuojnë në këtë, nëse është e nevojshme.

3.2 Zhvillimi i trajnimeve për stafin

Në takimin me shefat/drejtorët në ASK u vendos që do të përgatitet një program trajnimi duke u bazuar në prioritetet e departamenteve/divizioneve dhe analizën e anketës mbi kompetencat. Ky program trajnimi do t'i shërbejë edhe periudhës së mbetur të projektit të binjakëzimit, por edhe projekteve të tjera.

Gjatë diskutimeve u bë e qartë se stafi i njësisë të statistikave prodhuese në përgjithësi nuk janë të familjarizuar sa duhet me Kodin e Praktikës dhe modelin GSBPM. U rekomandua të mbahet një trajnim specifik mbi parimet e Kodit të Praktikës dhe GBPM gjatë vjeshtës së vitit 2015.

Përveç kësaj, rekomandohet që projekti i binjakëzimit të hulumtojë nëse është e mundur të ofrojë trajnime dhe asistencë në çështje, që lidhen me konfidencialitetin, për stafin e ASK-së (shih mëposhtë).

3.3 Fuqizimi i rëndësisë së çështjes së konfidencialitetit në ASK

Çështjet e konfidencialitetit janë një prioritet kyç për të gjitha institutet statistikore kombëtare. Ato duhet të adresohen si duhet dhe me kujdes. Edhe nëse nuk dalin/zbulohen të dhënat konfidenciale, ASK-ja duhet të emërojë një person, të specializuar në çështje të konfidencialitetit, i cili/e cila do të përgatiste një draft të politikës mbi konfidencialitetin për organizatën. Politika e konfidencialitetit do të duhej të diskutohej brenda organizatës dhe të miratohej nga menaxhmenti i lartë. Pjesa më e madhe e kësaj Politike duhet të publikohet në webfaqe. Është gjithashtu esenciale që stafi të familjarizohet me Politikën. Në periudhën më afatgjatë, duhet të ketë një Komitet të veçantë, që diskuton dhe ofron këshilla për ruajtjen e konfidencialitetit dhe trajtimin e rasteve të paqarta.

3.4 Rekomandimet për punën e Komitetit për Cilësi

Është dëm që akoma nuk është miratuar zyrtarisht mandati i Komitetit për Cilësi. Ekspertët rekomandojnë që kryesuesi i Komitetit të sqarojë urgjentisht këtë situatë dhe të mundohet që ky vendim të merret, sa më shpejt që është e mundur. Duhet të fuqizohet puna e këtij Komiteti dhe ajo të bëhet e rregullt. Komiteti për Cilësi duhet të përgatisë një plan pune dhe të punojë sipas tij. Ekspertët ritheksojnë që Komiteti duhet të punojë sipas modelit: planifikim-implementim-monitorim-vlerësim.

Me qëllim të përmirësimit të procedurave në prodhimin e statistikave, nga mbledhja e të dhënave deri te diseminimi, është përpiluar një “listë kontrolluese”. Kjo listë mund të përmirësohet dhe zgjerohet duke përfshirë më shumë procedura specifike dhe duhet të

zbatohet për të gjitha anketat. Lista e plotësuar duhet të ruhet dhe të përdoret për dokumentimin e kontrollit të cilësisë për anketat.

Një nga detyrat kryesore të Komitetit duhet të jetë plotësimi i pyetësorit vetë-vlerësues të BE-së lidhur me parimet e Kodit të Praktikës. Përveç kësaj, Komiteti për Cilësi do të duhej të plotësonte pyetësorin lidhur me koordinimin. Rekomandohet që këto dy detyra të realizohen deri në Tetor të vitit 2015. Gjithashtu, Komiteti ka për detyrë të përcjellë punën rreth metadatave dhe të sigurojë progresin dhe rezultate konkrete në këtë fushë.

3.5 Misioni i ardhshëm

Misioni 4.9.1 në Maj 2015 mbi Strategjinë dhe Politikën e Diseminimit do të përkrahë menaxhimin e cilësisë në ASK. Përveç kësaj, në Qershor të vitit 2015 do të ketë një vizitë në Danimarkë, ku do të prezantohen edhe çështjet që lidhen me cilësinë dhe praktikën e mira në Statistikat e Danimarkës. Rekomandohet që gjatë kësaj vizite të diskutohet edhe organizimi i një kursi trajnimi mbi Kodin e Praktikës dhe GSBPM për stafin e ASK-së. Gjithashtu, propozohet që pas emërimit të një personi në ASK për çështje të konfidencialitetit, homologu i tij/saj nga Danimarka do të mund të merrte pjesë në një mision për të ndihmuar rreth përcaktimit të funksioneve përkatëse dhe ofruar një trajnim.

Misionet e tjera të mundshme lidhur me punën rreth cilësisë do të diskutohen më tej dhe të vendosen më vonë, nëse e nevojshme.

Personat e takuar

1. Ramiz Ulaj, Kryesues i Komitetit për Cilësi, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë & TI
2. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit
3. Bekim Canolli, Menaxher i Cilësisë
4. Servete Muriqi, Anëtare e Komitetit për Cilësi
5. Xhevrie Fetahu, Anëtare e Komitetit për Cilësi
6. Ismail Sahiti, Anëtar i Komitetit për Cilësi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Administratës
7. Ilir Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
8. Burim Limolli, Shef i Ti-së
9. Sabri Zabergja, Drejtor i Regjistrimit dhe Anketave
10. Bajrush Qevani, Drejtor i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë
11. Bashkim Bellaqa, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
12. Bujar Hajrizi, AFP, Departamenti i Statistikave Sociale
13. Emina Deliu, ABEF, Departamenti i Statistikave Sociale
14. Avni Kastrati, Shef i Statistikave të Popullsisë
15. Haki Kurti, Shef i Divizionit të Ambientit
16. Naime Rexhepi, Shefe e Divizionit, Departamenti i Statistikave Sociale

Puna në të ardhmen

Veprimet e nevojshme si përgatitje për misionin e ardhshëm

Veprimi	Afati kohor	Personi/njësia përgjegjëse
Disa informata mbi rezultatet e anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve në webfaqen e ASK-së	Sa më shpejt që është e mundur	Ramizi
Një program trajnimi	Fundi i Prillit 2015	Ibrahimi/Nora
Strategjia dhe Politika e Diseminimit Përgatitja e anketës së ardhshme mbi kënaqshmërinë e përdoruesve	Maj 2015	Komiteti për Cilësi me ndihmën e Annegrete & Jesper
Planifikimi i një kursi trajnimi mbi çështje të cilësisë	Qershor 2015	Per
Pyetëtori i vetë-vlerësimit lidhur me Kodin e Praktikës	Fundi i Tetorit 2015	Ramizi/ Komiteti për Cilësi
Pyetëtori i vetë-vlerësimit lidhur me koordinimin	Fundi i Tetorit 2015	Ramiz/ Komiteti i Cilësisë

Aneksi 1. Termat e Referencës



EU Twinning Project KS12 IB ST 01 Support to Statistics

Termat e Referencës:

Komponenti 1: Një sistem Cilësie për Statistikat

Aktiviteti 1.2.1.2: Vazhdim i përkrahjes së punës rreth Cilësisë në ASK

Afatet kohore:

TeR –të gatshme: 1 Prill

Fillimi / Fundi I aktivitetit: 14-17 Prill 2015

Raportimi: 24 Prill 2015

Rezultati obligativ i komponentit:

Rezultati obligativ 1.2.1.2	Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika	Raportet mbi misionet, që ofrojnë këshilla operationale për sigurimin e cilësisë në fushën prodhimit statistikor, të publikuara në faqen e projektit	- Raportet tremujore të projektit të binjakëzimit - Raportet mbi misionet - Udhëzuesit	- Përkushtimi dhe disponeshmeri a në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit - Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve - Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
------------------------------------	---	--	--	--

Tema / qëllimi i aktivitetit: 1.2.1.2

Të ndihmohet rreth realizimit të një takimi me përdoruesit e statistikave zyrtare, në ASK.

Gjatë këtij aktiviteti gjithashtu do të vazhdojnë diskutimet dhe rekomandimet lidhur me organizimin e punës rreth cilësisë, duke përfshirë edhe arritjet që nga misioni i kaluar. Ekspertët do të diskutojmë më tej se si mund të implementohen më si miri në divizionet statistikore njohuritë e reja të fituara.

Çfarë pritët nga aktiviteti 1.2.1.2:

Raporti mbi misionin që paraqet gjendjen aktuale rreth cilësisë në ASK.

Rekomandimet për punën e mëtejme të Komitetit për Cilësi

Analizimi i rezultateve të vetëvlerësimit të Kodit të Praktikës

Propozimet për aktivitetet e ardhshme në komponentin 1.

Ekipi në ASK:

1. Ramiz Ulaj, Kryesues i Komitetit për Cilësi, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë & TI
2. Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit të Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit
3. Bekim Canolli, Menaxher i Cilësisë
4. Servete Muriqi, Anëtare e Komitetit për Cilësi
5. Xhevrie Fetahu, Anëtare e Komitetit për Cilësi
6. Ismail Sahiti, Anëtar i Komitetit për Cilësi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Administratës

Ekspertët e vendëve anëtare:

Z. Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistikat e Danimarkës, lth@dst.dk

Znj. Hilka Vihavainen, ish Drejtoreshe e Përgjithshme, Statistikat e Finlandes, hilkkal.vihavainen@gmail.com

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Historiku

6 misione në kuadër të projektit kanë shënuar progres në fushën e cilësisë:

- është formuar Komiteti për Cilësi
- është emëruar menaxheri i cilësisë
- është mbajtur një takim me përdoruesit
- është realizuar dhe analizuar një anketë mbi kënaqshmërinë e përdoruesve
- është finalizuar Rregullorja për Komitetin e Cilësisë (por akoma nuk është miratuar)
- është finalizuar Deklarata e Cilësisë (por akoma nuk është miratuar)
- është përpiluar një anketë mbi kompetencat e stafit dhe e njëjtja është analizuar

Tani Komiteti për Cilësi duhet të sigurojë që divizionet statistikore implementojnë cilësinë statistikore.

Para misionit, ekspertët kanë kërkuar që pjesëmarrësit të njihen më pyetësonin e vetë-vlerësimit të Kodit të Praktikës dhe udhëzuesit (nëse ata tashmë nuk e kanë plotësuar).

Të gjitha materialet e vetë-vlerësimit mund të gjenden në faqen e Eurostat-it
<http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/peer-reviews>

Aktivitetet, që duhet të ndëmirren si parapërgatitje për misionin:

- Raporti i misionit 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)
- Raporti i misionit 1.2.1: Një sistem cilësie për statistikën. Organizimi i punës rreth cilësisë (Thygesen)
- Raporti i misionit 1.2.1.1: Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika: Takimi me përdoruesit (Thygesen, Vihavainen, Wulff)

Aktivitetet e pritura janë:

- Rishikimi i punës që nga misioni i kaluar
- Rishikimi i gjendjes aktuale të punës rreth cilësisë
- Diskutimi dhe/ose plotësimi i pyetësonit të vetë-vlerësimit të Kodit të Praktikës
- Diskutimi dhe dakordimi i një plani për implementimin e cilësisë në ASK

Do të përgatiten:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit
- Një plan i detajuar për aktivitetet e ardhshme në lidhje me cilësinë në ASK

Aneksi 1, Programi, Prill 2015

Dita	Vendi	Koha	Aktiviteti
1	ASK	10:00-16:00	ASK: Prezantim i arritjeve që nga misioni i kaluar në Tetor 2014 VA: Diskutime mbi përmirësimin e cilësisë Planifikimi i javës
2	ASK	09:00-15:30	Diskutime rreth implementimit të cilësisë në ASK • Pyetësoni i vetë-vlerësimit i Kodit të Praktikës • Përgjegjësitë e Komitetit për Cilësi • Anketa mbi kompetencat, puna e mëtejme? Si të zhvillohen trajnimet dhe përmirësimi • Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Si të përdoren rezultatet • Takimi me përdoruesit. Takime të tjera me përdoruesit?

3	ASK	09:00- 16:00	Diskutime të mëtejme rreth implementimit të cilësisë në ASK Dakordimi mbi rekomandimet Takim me udhëheqësin e projektit: Rekomandimet, afatet kohore, aktivitetet për ASK-në Shkrimi i raportit